



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:276808

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06912912

C.nr.1088/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.K.D.Z., mësimdhënës në SHFMU "A.K." fshati B. komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Haki Kryeziu, avokat në Malishevë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, me objekt kontesti kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 2,021.81 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.K.D.Z., mësimdhënës në SHFMU "A.K." fshati B. komuna e Malishevës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, t'iu paguaj paditësve të lartcekur si në vijim:

Paditësit F.K.:

- Në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, t'ia paguaj paditësit të lartcekur për periudhën kohore 01.05.2021 deri më 21.11.2022 (gjithsej 19 muaj), shumën e përgjithshme prej 766.67 Euro (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent).

Paditësit D.Z.:

- Në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, t'ia paguaj paditësit të lartcekur për periudhën kohore 01.05.2021 deri më 21.11.2022 (gjithsej 19 muaj), shumën e përgjithshme prej 651.61 Euro (gjashtëqind e pesëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e një cent).

- Apo t'ua paguaj paditësve të lartcekur shumën e përgjithshme prej 1,418.28 Euro (njëmijë e katërqind e tetëmbëdhjetë Euro e njëzetë e tetë cent).

Të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 23.05.2024 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, për paditësin F.K. shumën prej 345.33 euro, ndërsa për paditësinë D.Z. shumën prej 258.20 euro, si e pabazuar.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 177.00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit, ndërsa REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar konkretisht shuma prej 4.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit F.K.D.Z., mësimdhënës në SHFMU "A.K." fshati B. komuna e Malishevës përmes së autorizuarit të tyre av. Haki Kryeziu, në këtë gjykatë me datën 23.05.2024, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë të punësuar tek e paditura si mësimdhënës në shkollën SHFMU "A.K." fshati B. komuna e Malishevës. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësi ka paraqitur padi përmes së cilës ka kërkuar që t'i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit të saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 27.01.2025, ku ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi lidhur me pagesën e inflacionit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive në bazë të nenit 35 pika 10 e kësaj kontrate si dhe kontrata e vitit 2021, për faktin se nuk kanë të dhëna për çka duhet të paguhet ky inflacion dhe sipas tyre nuk kanë prova konkrete nga Institucionet e Kosovës-BQK, çfarë rritje ekonomike ka pasur në Kosovë dhe se çfarë përqindje të inflacionit duhet paguar. Ka shtuar se padia është në tërësi e pa

bazuar pasi kjo padi është bërë vetëm në bazë të supozimeve dhe nuk ka të bëjë asgjë me inflacion, pasi nuk ka të dhëna se ku duhet të mbështetet kjo përqindje e rritjes së inflacionit dhe kjo normë e kontratës kolektive nuk mund të zbatohet. Ka theksuar se e paditura e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi kontrata kolektive e arsimit e lidhur mes SBASHK-ut dhe MASHT-it është shkëputur nga MASHT-i dhe kjo kontratë kolektive tanimë nuk është në fuqi, pasi palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe se i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT-i për SBASHK-un më dt. 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate për shkak të mungesës së bazës ligjore. Po ashtu ka shtuar se kjo padi ka arritur parashkrimin në bazë të nenit 352 dhe 353, par. 1 të LMD-së dhe se padia është e pasafatshme, pasi ky borxh është kërkuar që nga viti 2021, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2024 dhe se kontrata kolektive e vitit 2021 ka skaduar me dt.22.11.2022, dhe padia është paraqitur pas ndërprerjes së kontratës kolektive, andaj ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar sepse nuk ekziston asnjë bazë ligjore. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga lista e pagave, vërtetohet fakti se paditësit F.K. dhe D.S.janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SHFMU “A.K.” fshati B. komuna e Malishevës, ku paditësi F.K. është i punësuar si drejtor ndërsa paditësi D.Z. është i punësuar si mësues. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditësit F.K. është 495.30 euro sipas llogaritjes paga bazë – shtesa për kualifikim – shtesa në emër të viteve të përvojës së punës ($596.58 - 88.90 - 12.38 = 495.30$), ndërsa për paditësin D.Z. paga bazë është 421.00 €uro, gjithashtu u vërtetua se paditësi F.K. ka 6 vite përvojë pune, ndërsa paditësi D.Z. ka 12 vite përvojë pune. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë

21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga muaji maj të vitit 2021 (sipas datës së paraqitjes së padisë 23.05.2024 duke e llogaritur afatin ligjor) deri në muajin nëntor të vitit 2022 (brenda kërkesës së paditësit) sipas përlllogaritjes si në vijim:

Për paditësin e parë F.K.:

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2021 ka qenë 495.30 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 8 mujore në total të jetë 134.72 Euro, apo 16.84 Euro për muaj ($495.30 \times 3.4\% \times 8 = 134.72$ Euro).
- Për periudhën Janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2022 ka qenë 495.30 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 439.47 Euro, apo 48.83 Euro për muaj ($495.30 \times 11.6\% \times 11 = 631.95$).

E që 134.72 (2021) + 631.95 (2022) = në total 766.67 euro.

Për paditësin e dytë D.Z.:

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2021 ka qenë 421.00 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 8 mujore në total të jetë 114.48 Euro, apo 14.31 Euro për muaj ($421.00 \times 3.4\% \times 8 = 114.48$ Euro).
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses e cila në vitin 2022 ka qenë 421.00 Euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 537.13 Euro, apo 48.83 Euro për muaj ($421.00 \times 11.6\% \times 11 = 537.13$).

E që 114.48 (2021) + 537.13 (2022) = në total 651.61 euro

Duke qenë se mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.05.2021 deri me datë 22.11.2022, në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka

kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.05.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përbushjen e obligimit ndaj paditësit.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi pjesërisht të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës shprehimisht theksohet që: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 23.05.2024, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përqindjes së inflacionit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 30.04.2021. Më konkretisht, me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 23.05.2024, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.05.2021 e deri më 22.11.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 23.05.2024, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin maj 2021, pasi parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin maj 2021 ka filluar të rrjedh vetëm pasi i njëjti ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht i njëjti pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin maj 2021 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht qershor, i njëjti ka mundur të kërkojë përbushjen e detyrimit. Kështu, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë*

përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.

E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga muaji maj të vitit 2021, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në muajin nëntor të vitit 2022 sa ishte në fuqi Kontrata Kolektive, ndërsa po ashtu e refuzoi kërkesëpadinë për muajin dhjetor 2022, pasi që kontrata kolektive nuk ishte në fuqi në këtë periudhë kohore të kërkuar, po ashtu refuzoi kërkesëpadinë mbi shumën e aprovuar si në dispozitivin e I të këtij aktgjykimi pasi që paditësit kanë kërkuar diferencën e pagës sipas inflacionit për paditësin F.K. për pagën bazë 529.61 euro, fakt i cili nuk qëndron pasi që sipas listës së pagave gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka pagën bazë 495.30 euro, ndërsa po ashtu për paditësin D.Z. për pagën bazë 458.97 euro, fakt i cili nuk qëndron pasi që sipas listës së pagave gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka pagën bazë 421 euro, për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket pjesës së kërkesës së paditësit lidhur me shkallën e inflacionit të kërkuar prej 14.10% për vitin 2022, gjykata gjen se bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin për vitin 2022 ka qenë 11.6%, ndërsa sipas kësaj gjykata ia përlllogariti shkallën inflacionit për vitin 2022 prej 11.6%, e jo sikurse ka kërkuar paditësi në shkallë prej 14.10%, andaj të njëjtën gjykata nuk e mori për bazë gjatë përlllogaritjes, por e mori për bazë Indeksin e lartcekur të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 156.00 €uro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 €uro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), ndërsa u refuzua shuma prej 4.00 euro e kërkuar në emër të përpilimit të padisë, mbi shumën e aprovuar për përpilim padie (156).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil
C.nr.1088/24, datë 27.02.2025

G j y q t a r j a
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.